

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjykatësve Gëzim Llulluni kryetar i kolegjit dhe Nora Bllaca-Dula e Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit M. B. nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari e përfaqësuar nga A. M. nga Gjilani, për kompensimin e diferencës së pagave, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarës së të paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.154/2021 të dt. 18.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.12.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të autorizuarës së paditësit, M. B. nga Gjilani, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.154/2021 të dt. 18.03.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar në pikën I të dispozitivit, Gjykata Themelore në Gjilan, shpallet inkompetente në pikë pamje lëndore për vendosjen e çështjes civile dhe hudhet poshtë si e pa lejuar padia e paditësit M. B. nga Gjilani, e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari, për shkak të kompensimit të diferencës së pagave. Me të njëjtin aktvendim në pikën II të dispozitivit theksohet se pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi, lënda C.nr.154/2021 të arkivohet në Arkivin e Gjykatës .

Duke vepruar sipas kërkesës së përfaqësueses së autorizuar të paditësit, për përmirësimin e Aktvendimit C.nr.154/2021 të datës 18.03.2021, gjykata e shkallës së parë ka marrë Aktvendimin C.nr. 154/2021 të datës 12.04.2021 me të cilin e ka përmirësuar Aktvendimin C.nr. 154/2021 të datës 18.03.2021, në pikën e I-rë të dispozitivit të tij ashtu që hiqen fjalët “hudhet poshtë si e pa lejuar padia” kurse mbeten të pa ndryshuara fjalët në vijim sa i përket pikës së I-rë të dispozitivit, e po ashtu në pikën e II-të të dispozitivit të këtij Aktvendimi hiqet komplet fjalia dhe në vijim saktësohet me fjalët “Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi lënda C.nr.154/2021 i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e autorizuara e paditësit për shkak të: Shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstastimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa me aprovimin e ankesës aktvendimi i atakuar të ndryshohet, ose të priset, dhe çështja ti kthehet Gjykatës Themelore në Gjilan, në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, duke vepruar në kuptim të nenit 194 lidhur me nenin 208 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ka vlerësuar aktvendimin e atakuar në kuadër të kufijve të arsyeve të theksuara në ankesë, duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 e 2 dhe zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësi ka parashtruar padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar kompensimin e diferencës së pagave.

Gjykata e shkallës së parë pas kthimit të çështjes në rivendosje nga Gjykata e Apelit, ka vepruar sipas vërejtjeve të kësaj gjykata dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare lidhur me kompetencën lëndore të gjykatës në pajtim me nenin 17 dhe 18.2 të LPK-së është shpallë jo kompetente lëndore, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar. Lidhur me këtë vendim të sajë gjykata e shkallës së parë, është arsyetuar se paditësi sipas Akt Emërimit nr.16-54058 të dt. 16.11.2011 i lëshuar nga Komuna e Vitisë, ka pozitën Roje Pyelli dhje se marrëdhënia e tij e punës rregullohet me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji nr. 03/L-149 i dt. 01.Dhjetor 2011 dhe se të drejtën subjektive paditësi mund ta ushtrojë në instancën e fundit duke hapur konflikt Administrativ sepse me nenin 4 të Ligjit të lartë cekur janë përcaktuar kategoritë e të punësuarve që marrëdhënia e tyre e punës rregullohet konform dispozitave të këtij ligji si dhe nenit 81 par.2 në të cilën dispozitë është përcaktuar procedura e realizimit të të drejtave të shërbyesve civil. Pas kryerjes së procedurave pranë organeve administrative më pastaj mund të hapet edhe Konflikti Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjendjen faktike e ka mbështetur në dispozitat e nenit 17 dhe 18.2 lidhur me nenin 389 të LPK-ës dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Lëshimet e bëra në Aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë i ka përmirësuar me Aktvendimin C.nr. 154/2021 të datës 12.04.2021, duke e bërë përmirësimin e aktvendimit të atakuar ku i ka hequr fjalët “hudhet poshtë si e pa lejuar padia” kurse mbeten të pa ndryshuara fjalët në vijim sa i përket pikës së I-rë të dispozitivit, e po ashtu në pikën e II-të të dispozitivit të këtij Aktvendimi hiqet komplet fjalia dhe në vijim saktësohet me fjalët “Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi lënda C.nr.154/2021 i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Për mënyrën e vendosjes në këtë aktvendim gjykata e shkallës së parë i referohet dispozitave të nenit 17 dhe 18 si dhe nenit 165 pika 1 dhe 2 të LPK-së, dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit, në fjalë.

Në këtë aktvendim nuk është paraqitur ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 194 e lidhur me nenin 182 par. 2 pika b), g), j), k) dhe m) në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare. Njëherit gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale kur ka vendosur që të shpallet si gjykatë jo kompetente në këtë çështje juridike dhe shkresat e lëndës ti përcjell Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për çështje Administrative, si gjykatë kompetente për të vendosur për këtë çështje.

Për vendimin e vet duke përfshirë me këtë rast edhe ate përmirësues, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftuara e të cilat arsye i pranon në tërësi edhe kjo gjykatë, e duke u bazuar në nenin 13 par. 1 nën par. 1 të Ligjit për gjykatat e rregullta dhe në mendimin juridik të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr.217/13 të dt. 25.03.2013. Prandaj në bazë të cekurave del se gjykata e shkallës së parë në tërësi ka zbatuar drejtë të drejtën materiale dhe drejtë ka vendosur që të shpallet jo kompetent për të vendosur në këtë çështje civile juridike.

Gjykata vlerësoj edhe pretendimet ankimore të autorizuarës së paditësit lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave procedurale respektivisht të nenit 182.1 lidhur me nenin 18 par.2 të LPK-së por se të njëjtat mbas aktvendimit përmirësues ishin pa ndonjë relevancë të caktuar për vendosje lidhur me çështjen e paditësit në rastin konkret. Pra lidhur me pretendimet e tilla të palës paditëse, gjykata gjeti se janë të pabazuara dhe nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe nga ata të cilët i ka marr gjykata e shkallës së parë.

Kështu që duke i nisur nga fakti se në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, paditësi ishte shërbyes civil, atëherë çështja lëndore e tij në rastin konkret, është kompetencë lëndore e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrativë, ashtu siç ka konsideruar edhe gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar për fshirë edhe aktvendimin përmirësues.

Prandaj, nga të paraqiturat e në kuptim të nenit 209 par.1 pika b) të LPK-së është vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3937/2021, më datë 29.12.2021

Kryetar i kolegjit-gjykatësi
Gëzim Llulluni